



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Nr. 7-004/02/16

Junik

Dt.16.03.2016

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës nenet 7 dhe 8, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr 04/L-032, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr 20/2013, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 06/2015, Orari i plote për mësimdhënës/e parafillor/ UA nr. 22/2013 Vendimit nr. 214/01B, të datës 23.07.2015, dhe Vendimit nr. 225/01B, të datës 30.07.2015, për plotësimin e U/A nr. 06/2015, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini e Sport në Komunën e Junikut shpallë:

KONKURS

Për plotësim e vendit të lirë të punës për vitin shkollor 2016/2017

Shkolla fillore e mesme e ulët “Edmond Hoxha” në Junik

Një (1) Mësimdhënës/e parafillor/e

kualifikimet dhe shkathtësitë e nevojshme- Dokumentacioni i kërkuar:

- Fakulteti i edukimit – programi parashkollor, shkolla e lartë pedagogjike – drejtimi për edukatorë, fakulteti filozofik – dega e pedagogjisë, fakulteti i shkencave sociale – programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijës.
- Të ketë njohuri për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme, të drejtave të fëmijëve dhe të mbrojtjes së fëmijëve.
- Shkathtësi që të punojë në mënyrë të përshtatshme, fleksibile dhe efektive në punë ekipore.
- Të ketë aftësi në përdorimin e programeve kompjuterike.
- Të ketë kreativitet, strategji dhe metoda bashkëkohore të mësimdhënies.
- Dëshmitë për trajnimet e vijuara për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme janë përparësi.
- Diploma (çertifikata) në origjinal ose fotokopje e vërtetuar nga organi përkatës,
- Letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik.
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim.
- Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e shpalljes.
- Për ditën e intervistimit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.

Drejtori i Drejtorisë për AKRS
Fatos Shala

